



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 nr.08-175
13.06.2024
Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, neni 24 paragrafi (5) të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014, Njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit televiziv nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup, nr.yinë ark.08-2630/1 datë 04.06.2024, Deklaratë, nr.UZP 7142/2024 datë 06.06.2024, nr.yinë ark.08-2630/3 datë 06.06.2024 nga themelues i vetëm/pronar i transmetuesit, dhe Konkluzionin me ark.nr.02-2697/6 datë 13.06.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 26-të mbajtur më 12.06.2024 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë, dhe do të zbatohet pas kryerjes së pagesës së kompensimit për Lejen e transmetimit televiziv, PA1 nr.08-319 datë 22.05.2018 nga ana e transmetuesit në pajtim me faturën e dhënë nga ana e Agjencisë vetëm për periudhën e punës, gjegjësisht nga 04.05.2024 deri më 31.05.2024.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup, është posedues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-319 datë 22.05.2018, (me periudh të vlefshmërisë nga 04.05.2018 deri më 03.05.2027), që transmeton program nëpërmjet operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse të kufizuara, në nivel rajonal në zonën D7 - Stogovë (Komuna Dibër, Komuna Centar Zhupë dhe Komuna Mavrovë dhe Rostushë), shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke.

Më datë 03.06.2024 SHTR TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) dorëzoi njoftim për ndërprerje me transmetim të programit televiziv (nr.yinë ark.08-2630/1 datë 04.06.2024), se SHTR TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup, për shkak të defektit teknik në pajisje që ndodhi më datë 31.05.2024, si dhe për shkak të gjendjes së vështirë financiare të transmetuesit do të ndërpresë me transmetim të programit televiziv. Me rastin e njoftimit të cituar, Agjencia më 05.06.2024, me Shkresë nr.yinë ark.08-2630/2, e njoftoi transmetuesin në fjalë se në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) është e nevojshme të dorëzon deklaratë me shkrim të noterizuar nga themeluesi/ pronari i vetëm i transmetuesit, i cili detyrimisht duhet të deklaron se transmetuesi SHTR TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup ndërpreu me transmetim të programit televiziv, me datën e saktë të ndërprerjes me

transmetim të programit televiziv. Njëkohësisht, transmetuesi ishte njoftuar se në lidhje me këtë SHTR Televizioni 3 SHPKNJP Shkup, ka (posedon) borxh ndaj Agjencisë për kompensimin e lejes për transmetim televiziv, është e nevojshme të përmbushë detyrimin financiar ndaj Agjencisë.

Konkretisht, pas miratimit të këtij Aktvendimi, në pajtim me nenin 24 paragrafi (5) të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë, të SHTR TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup, Agjencia do t'i lëshojë faturë të re, e cila do t'i referohet vetëm periudhës së punës, gjegjësisht nga 04.05.2024 deri më 31.05.2024 - periudhë e cekur në Deklaratën e dorëzuar (e noterizuar) UZP nr.7142/2024 datë 06.06.2024, faturë e cial duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj. Fatura e dorëzuar më parë, nr.2024-100-0143 datë 07.05.2024 (nr ynë.ark05-2209/1 datë 07.05.2024) për kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv të SHTR Televizioni 3 SHPKNJP Shkup për periudhën nga 04.05.2024 deri më 03.05.2025, e dhënë nga ana e Agjencisë do të anulohet.

Më datë 06.06.2024 drejtuar Agjencisë nga SHTR TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup, është dorëzuar Deklaratë me nr.UZP 7142/2024 datë 06.06.2024 (e noterizuar), nr.ynë ark.08-2630/3 datë 06.06.2024, nga themelusi/pronari i vetëm i transmetuesit – Viktor Serafimov, se SHTR TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup deri më 31.05.2024 ndërpreu me transmetim të programit televiziv, si dhe do kryejë pagesën e kompensimit për Lejen, PA1 nr.08-319 datë 22.05.2018, në pajtim me faturën e dhënë nga Agjencia, jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, gjegjësisht nga data 04.05.2024 deri më datë 31.05.2024.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), leja për transmetim televiziv ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratën me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programit televiziv. Për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion në bazë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjenciado të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi (2) nga LSHMAAV).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, me dorëzimin e Deklaratës me shkrim të lartpërmendur nga themeluesi/ pronari i vetëm i transmetuesit (e noterizuar), si dhe me përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj Agjencisë për kompensim të lejes nga ana e transmetuesit, janë plotësuar kushtet ligjore për ndalimin e vlefshmërisë së lejes sipas fuqisë ligjore, nga ku Agjencia do të fshijë transmetuesin SHTR Televizioni 3 SHPKNJP Shkup nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, neni 24, paragrafi (5) të Rregullores për procedurat financiare dhe kontabël të punës së Agjencisë, Njoftimin për ndërprerje me transmetim të programit televiziv nga SHTR TELEVISIONI 3 SHPKNJP Shkup, nr ynë.ark.08-2630/1 datë 04.06.2024, Deklaratën me nr.UZP 7142/2024 datë 06.06.2024, nr ynë.ark.08-2630/3 datë 06.06.2024 nga themeluesi/ pronar i vetëm i transmetuesit dhe Konkluzionin ark.nr. 02-2687/6 datë 13.06.2024, është marrë vendim si në dispozitiv, i cili hyn në fuqi menjëherë, dhe do të zbatohet pas pagesës së kryer në dhogari të Agjencisë nga ana e transmetuesit, në pajtim me pikën 3 të këtij aktvendimi.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.